

Mbi Auditimin e Ushtruar në Degën e Doganës, Vlorë

Raporti Përfundimtar i Auditimit të ushtruar në Degën e Doganës, Vlorë, me objekt “Mbi zbatimin e legjislacionit doganor” për periudhën 01.07.2012–31.12.2013 dhe verifikimin e periudhave të mëparshme si dhe masat për përmirësimin e gjendjes, janë miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH-së nr. 70, datë 30.06.2014.

Bazuar në nenet 9 dhe 16 të ligjit nr. 8270, datë 23.12.1997 “Për Kontrollin e Lartë të Shtetit”, me ndryshimet e bëra me ligjin nr. 8599, datë 01.06.2000, me shkresën nr. 222/20, datë 30.06.2014 dhe nr. 222/19, datë 30.06.2014, Raporti Përfundimtar i Auditimit dhe rekomandimet përkatëse, i janë dërguar znj. Elisa Spiropali, Drejtor i Përgjithshëm i Doganave, Tiranë dhe z. Kasem Cenaj, Kryetar i Degës Doganës, Vlorë.

Kontrolli i Lartë i Shtetit ka rekomanduar dhe kërkuar zbatimin e masave të mëposhtme:

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Nga Dega e Doganës Vlorë të ngarkohet një punonjës për ndjekjen dhe evidentimin në vazhdimësi dhe rregullisht të realizimit të planit të të ardhurave.

2. Dega e Doganës Vlorë në funksion të implementimit të kërkesave të ligjit nr.10296, datë 8.7.2010 “*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*”, titullari i njësisë, të hartojë politikat, të miratojë dhe monitorojë objektivat e njësisë publike që ai drejton, planet strategjike e vjetore, strategjinë e menaxhimit të riskut dhe të plan-veprimeve për arritjen e objektivave.

3. Nga Dega e Doganës Vlorë të miratohen akte të brendshme administrative për ruajtjen, mbrojtjen e nxjerrjen jashtë përdorimi të aktiveve të njësisë dhe për zbatimin e rregullave për kontrollin e brendshëm bazuar në ligjin nr. 10296, datë 8.7.2010 “*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*” dhe Manualin “*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*”.

4. Dega e Doganës Vlorë në rastet e transferimeve apo largimeve të doganierëve të sektorit klasifikim/vlerë apo regjimesh me vendim apo urdhër të përcaktojë personin që do të marrë, ndjekë e kryejë këto detyra, të cilat rezultojnë me shumë probleme.

5. Dega e Doganës Vlorë me sektorin e borxhit:

-Referuar nenit 245 të Kodit Doganor; nenit 103.1/a/b, 103.2/2 dhe 103.3/5/5 të ligjit 61/2012 “Për akcizat në RSH” si dhe Udhëzimit nr.4 datë 04.08.2006 i ndryshuar me Udhëzimin nr.11569/2prot datë 23.07.2013 të DPD “*Për zbatimin praktik të procedurës së evidentimit, kontabilizimit dhe vjeljes së borxhit doganor dhe akcizës*”, të ndjekë të gjitha procedurat ligjore për ***rikuperimin dhe vjeljen e borxhit doganor në shumën 279,277 mijë lekë.***

-Referuar nenit 245 të Kodit Doganor si dhe Udhëzimit nr. 4 datë 04.08.2006 i ndryshuar me Udhëzimin nr.11569/2prot datë 23.07.2013 të DPD, të ndjekë të gjitha procedurat ligjore për rikuperimin dhe vjeljen e borxhit doganor në shumën 7,981,438 lekë konstatuar nga Grupi i Auditimit, gjatë procesit të ballafaqimeve, ku u bënë prezent procesverbalet pa vendim administrativ, nga ana e autoritetit vendimmarrës është dalë me vendimin administrativ nr.47, datë 07.04.2014.

6. Nga Dega e Doganës Vlorë të merren masa që të bëhen efektive marrëveshjet e lidhura me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve dhe Zyrën e Regjistrimit të Pasurive si dhe bashkëpunimi me Bankat e nivelit të dytë, QKR dhe Zyrat Përmbarimore për zbatimin e Urdhrave të Ekzekutimit të lëshuara nga Gjykata, për vjeljen me forcë të borxhit doganore.

7. Nga Dega e Doganës Vlorë të merren masat për kompletimin e dosjeve të subjekteve që operojnë në fushën e akcizës sipas kërkesave të ligjit nr. 61/2012, “*Për Akcizat në Republikën e Shqipërisë*”, dhe VKM nr. 612/2012 “*Për Dispozitat Zbatuese të Ligjit për Akcizat*”.

8. Nga Dega e Doganës Vlorë të krijohet regjistri aktiveve të qëndrueshme dhe të pasqyrohet me të dhënat e nevojshme, si data e hyrjes, vlera e blerjes, vlera e shpenzimeve të mirëmbajtjes, amortizimi i akumuluar, sipas kërkesave të Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*” kapitulli III -të.

9. Nga Dega e Doganës Vlorë për: DAV, R-2778, datë 26.02.2013, nëpërmjet dokumentacionit të saktë shtesë, të përlogariten detyrimet e sakta doganore dhe penalitetet, që rezultojnë nga veprimi jo në përputhje me kërkesat e nenit 21 të Protokollit të Origjinës. Për DAV, R-7501, datë 16.06.2012; R-10983, R-10985, datë 26.07.2013 dhe R-13643, R-13645, R-13646, datë 18.09.2013, të verifikohet pretendimi në lidhje me dokumentacionin origjinal që mbulon mallrat e deklaruar në këto deklarata doganore.

B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

B.1. Nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave të kryhet kontabilizimi dhe të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit në vlerën **748,652 lekë**, nga 3 punonjës sipas aneksit nr. 12 të Raportit Përfundimtar të Auditimit, (trajtuar në faqet 76-83 të Raportit Përfundimtar të Auditimit), për konsum të pajustificuar të karburantit.

B.2. Nga Dega e Doganës Vlorë të kryhet kontabilizimi dhe të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit në vlerën **86,872,883 lekë**, (*shuma 7,981,438 lekë e konstatuar nga Grupi i Auditimit, zbritet pasi nga ana e autoritetit vendimmarrës është dalë me vendimin administrativ nr.47, datë 07.04.2014, e cila është trajtuar te “MASA ORGANIZATIVE”, pika nr.6*); në mënyrë analitike si më poshtë:

1. Vlera prej **2,800 lekë**, për diferencë midis sasisë së mallit të konfiskuar dhe sasisë së mallit të bërë hyrje në magazinë, (trajtuar në faqen 69 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

2. Vlera prej **78,888,645 lekë** nga subjektet me detyrime të papaguar si dhe revokimit të vendimeve administrative të nxjerra jo në përputhje me ligjin në mënyrë analitike si më poshtë:

2.1. Vlera prej **32,777,186 lekë** nga 162 raste sipas aneksit 1; 2; 3; 4; 5; 6; 7 dhe 8 të Raportit Përfundimtar të Auditimit. (Trajtuar hollësisht në faqet 13-23 dhe 24-47 të Raportit Përfundimtar të Auditimit) si rezultat i veprimeve jo në përputhje me kërkesat e neneve 34-39; 256.2; 275.1; 287.2/f; 256.4; 261.1; 261.2 dhe 261.3 të Kodit Doganor; i veprimeve jo në përputhje me përcaktimet e kërkesave të Sesionit I të Udhëzimit 25, datë 30.11.2007 të MF *“Për procedurat e shqyrtimit të vlerës doganore...”* si dhe veprimeve jo në përputhje me përcaktimet e kërkesave të *“Protokollit të Origjinës”* gjatë procedurave të zhdoganimit të mallrave.

2.2. Vlera prej **30,435,664 lekë** nga 8 subjekte sipas aneksit 9 të Raportit Përfundimtar të Auditimit. (Trajtuar hollësisht në faqet 47-53 të Raportit Përfundimtar të Auditimit) si rezultat i veprimeve jo në përputhje me kërkesat e neneve 256.1/a; 256.2; 256.4; 275.1; 74.1/b; 274.1/2; 271.1; 271.2/a; 271.2/b dhe 287.2/f të Kodit Doganor; i veprimeve jo në përputhje me përcaktimet e kërkesave të përcaktuara në pikën 300.1,2,3 të VKM^{së} nr.205, datë 13.04.1999 *“Për Dispozitat Zbatuese të Kodit Doganor”* gjatë procedurave të regjimeve të përpunimit aktiv.

2.3. Vlera prej **14,443,748 lekë** nga **39 raste** sipas aneksit 10 dhe 11 të Raportit Përfundimtar të Auditimit. (Trajtuar hollësisht në faqet 56-69 të Raportit Përfundimtar të Auditimit), si rezultat i revokimit të akteve administrative, të nxjerra jo në përputhje me kërkesat e neneve 256.4, 275.1; 289.1; 274.1; 74.1/a; 274.2; 78.1; 261.1, 261.2 dhe 273.2 të Kodit Doganor.

2.4. Vlera prej **1,232,047 lekë** nga **13 raste** sipas aneksit 13 të Raportit Përfundimtar të Auditimit. (Trajtuar hollësisht në faqet 84-88 të Raportit Përfundimtar të Auditimit) si rezultat i veprimeve jo në përputhje me kërkesat e neneve 261.1; 287.1 dhe 289.1 të Kodit Doganor gjatë procedurave të vendimmarrjes.

C. MASA ADMINISTRATIVE

Bazuar në nenet 275.1 dhe 287.2/f të Kodit Doganor, mbështetur në faktet e vërtetuara dhe në të dhënat e grumbulluara gjatë auditimit, i rekomandojmë **Degës së Doganës Vlorë** të aplikojë penaltitet në masën nga **50,000 lekë deri në 200,000 lekë**, për:

1. Për agjencinë doganore . [REDAKTUAR] për problemet e konstatuara në përpilimin e DAV, si dhe janë deklaruar dhe zhdoganuar me MSABE artikuj me deklarata faturë me **vlerë totale mbi 6000 €**, pa certifikatë EUR.1 me pasojë shmangien nga detyrimet doganore, të gjitha këto 20 raste, në shkelje të neneve 256.1/a; 256.2; 275.1; 261.1; 261.3 dhe 287.2/f të Kodit Doganor të Republikës së Shqipërisë.

D. MASA DISIPLINORE

Mbështetur në nenin 59, të ligjit nr. 152/2013 *“Për nëpunësin civil”* dhe VKM nr. 115, datë 05.03.2014 *“Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil”*, i rekomandojmë Kryetarit të Degës Doganës, Vlorë që në vlerësim të shkeljeve të mëposhtme sipas pikës 1 të nenit 57 të ligjit nr. 152/2013 të konsideruara nga ana jonë si shkelje të rënda dhe shumë të rënda, të bëj klasifikimin e tyre dhe të urdhërojë fillimin e procedurave

përkatëse për shqyrtimin dhe dhënien e masës përkatëse , sipas VKM nr. 115, datë 05.03.2014 dhe ligjit nr. 152/2013, për nëpunësit civil, si më poshtë:

1. Për [REDAKTUAR] me detyrë Jurist/Specialist borxhi në Degën e Doganës Vlorë, për shkeljet e konstatuara në kryerjen e detyrave funksionale të përcaktuara në nenin 14.5 të Rregullores së Brendshme të Degëve Doganore, konkretisht:

- për procedurat e konstatimit të shkeljeve doganore duke u bërë pjesë e procesverbaleve të konstatimit;
- për procedurat e trajtimit dhe mos konceptimit të vendimeve administrative kur i janë deleguar procesverbale apo shkresa për vendimmarrje, jo në përputhje me nenin 287 të Kodit Doganor;
- për trajtimin dhe klasifikimin e shkeljeve doganore jo në përputhje me natyrën e shkeljeve të përcaktuara në kapitullin VIII të Kodit Doganor;
- për vonesa në konceptimin e akteve administrative, jo në përputhje me nenin 287 dhe 289.1 të Kodit Doganor; në total për **83 (tetëdhjetë e tre) raste**. (Trajtuar hollësisht në faqet 35, 51, 56-68 dhe 87 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Shënim: Për përgjegjësitë mbi të metat dhe mangësitë e konstatuara, të trajtuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit, **për 7 ish-punonjësit** e poshtë cituar nuk rekomandohet masë pasi janë të larguar nga sistemi doganor.

1. [REDAKTUAR] në cilësinë e ish-doganier klasifikim/vlerë dhe ish-përgjegjës i zyrës operacionale për 85 raste;
2. [REDAKTUAR] në cilësinë e ish-përgjegjës i zyrës operacionale për 76 raste;
3. [REDAKTUAR] në cilësinë e ish-doganier klasifikim/vlerë për 74 raste;
4. [REDAKTUAR] në cilësinë e ish-doganier klasifikim/vlerë; ish-përgjegjës i zyrës operacionale dhe ish- kryetar për 69 raste;
5. [REDAKTUAR] në cilësinë e ish-përgjegjës i zyrës operacionale për 37 raste;
6. [REDAKTUAR] në cilësinë e ish-doganier klasifikim/vlerë për 23 raste;
7. [REDAKTUAR] në cilësinë e ish-doganier regjime/përrjashtime për 17 raste.

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të të Ardhurave të Buxhetit të Shtetit.

Auditimi u krye nga audituesit Agron Opari, p/grupi, Hekuran Avdulaj, Marvin Karalli, më tej u shqyrtua nga Kryeauditues z. Albert Thoma, Drejtori i Drejtorisë Juridike, Sigurimit të Cilësisë dhe Analizës së Riskut z. Ermal Yzeiraj, Drejtori i Departamentit znj. Albana Agolli si dhe u verifikua si praktikë nga Sekretari i Përgjithshëm, znj. Luljeta Nano.

Mbi zbatimin e rekomandimeve:

Dega e Doganës, Vlore, nuk ka kthyer përgjigje për zbatimin e rekomandimeve.

KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Punoi: Albana AGOLLI